



PROBLEMET QË REZULTUAN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË MBROJTJES SË LIQENIT POGRADEC NGA NDOTJA E UJRAVE TË LUMENJVE TË PELLGUT UJËMBLEDHËS NË BASHKINË POGRADEC DHE MASAT QË DUHEN TË MERREN PËR ZGJIDHJEN E TYRE.

Prioriteti kryesor i zhvillimi ekonomik të Bashkisë Pogradec është rritja e e turizmit. Ky prioritet është i diktuar nga vetë pozicioni gjeografik i territorit ku shtrihet kjo bashki. Rreth 80% e popullsisë së Bashkisë Pogradec jeton dhe punon në pellgun ujëmbledhes të liqenit të Pogradecit. Vlerat natyrore dhe mjedisore të këtij liqeni janë tashmë të njohura në mbarë botën, pasi ai është pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mbrojtur nga UNESCO.

Në këtë kuadër zivillimi i turizmit është i lidhur ngushtë me mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht me mbrojtjen e cilësisë së ujrave të këtij liqeni, të florës dhe faunës që gjenden në liqen dhe pellgun ujëmbledhës të tij.

Për mbrojtjen e kësaj pasurie, tashmë ekziston një bazë e plotë ligjore si ligji nr 10431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligji nr 10440, date 07.007.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ligji nr 10463, date 22.09.2011, “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe veçanërisht ligji nr 9103, date 10.07.2003, “Për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare”.

Gjithashtu me Vendimin nr 80, datë 18.02.1999 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pellgu ujëmbledhës dhe liqeni i Pogradecit është shpallur “Peisazh i Mbrojtur Tokësor Ujor”, kategoria e V menaxhuese sipas IUCN.

Krahas bazës ligjore, është ekzistuar dhe struktura administrative për mbrojtjen e liqenit ku rolin primar e luan Bashkia Pogradec me strukturat e saj, Agjensia e Zonave të Mbrojtura me Drejtorinë e saj Rajonale në Korçë, Policia e Shtetit, Agjensia Rajonale e Mjedisit, Komiteti i Përbashkët Shqipëri Maqedoni për menaxhimin e Liqenit të Ohrit.

Njëkohësisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe shumë organizata dhe shoqata mjedisore, të cilat me veprimtarinë dhe projektet e tyre mjedisore kanë rritur ndërgjegjesimin e komunitetit dhe



perceptimin qytetar per rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit në pellgun ujëmbledhes,dhe veçanërisht të trupit ujqor të liqenit.

Mbrojtja e cilesise te ujit veçanërisht e burimeve natyrore të tij dhe gjithë tribunareve të lumenjve, që furnizojnë liqenin me ujë dhe i perkasin territorit te Bashkise Pogradec eshte nje nga prioritetet e ketij projekti mjedisor.

Burimet kryesore të ujrave të liqenit për pjesë shqiptare janë ato të Drilonit, fshatit Guras dhe Tushemisht. Për burimet nëntokësore iështë dhënë rendësi pezullimit dhe ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së guroveve, të cilat kishin impact negative në prurjet dhe intoksinimin e ujrave.

Problemi më kryesor në ndotjen e ujrave që derdhen në liqen dhe ndikojnë negativisht në cilësinë e ujrave dhe florën dhe faunën e tij, janë ujqrat e lumenjve dhe liqeneve. Kujdes duhet treguar dhe ne ndalimin e larjes së teshave me detergjentë nëdirekt në ujqrat e liqenit në qytet dhe në çezmat natyrore të Burimave të Pogradecit.

Ndotja e ujrave të lumenjve dhe përenjve është i lidhur ngushtë me zbatimin e ligjitnr 10463, date 22.09.2011, “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe Vendimin e K.M nr 229, date 23.04.2014 per transferimin e mbetjeve.

E veçanta e gjithë lumenjve që derdhen në liqen është se ato kalojnë mes për mes fshatrave. Kjo në fakt përbën në pasuri mjedisore të tyre sepse uji është jetë dhe sjell gjelbërim dhe freski për banorët, por që fatkeqësisht janë kthyer në qëndra të grumbullimit të mbetjeve urbane.

Për disa fshatra këta lumenj janë kthyer dhe si rrezik per përmytjen e banesave të komuniteti,sin ë Vërdovë,Rëmenj, Çërrave etj.

Gjatë takimeve të ndërgegjesimit me komunitetin, që banon pranë lumenjve që derdhen në liqenin e Pogradecit,si dhe monitorimi dhe vrojtimi i hollesishem që u krye gjatë kësaj periudhe, u konstatuan disa problem mjedisore, qe ndikojnë direkt në cilesinë e ujit të liqenit dhe si pasojë në florën dhe veçanërisht faunën dhe specie endemike të peshqëve të këtij liqeni.

Si rezultat i ndertimit dhe vënies në përdorim të impiantit të pastrimit të ujrave të zeza ne qytetin e Pogradecit dhe disa fshatra përëth tij cilesia e ujit ne liqen është rritur dukshëm dhe liqeni është



në fazën e vetëpastrimit, për vetë kushtet specifike të tij. Pozitivisht ka ndikuar dhe vënia në kontroll e territorit nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, duke i dhënë fund ndertimeve të paligjeshme.

Prishja e ndërtimeve të paligjeshme dhe rikonstruksioni i rruges Pogradec - Lin, krahas përmiresimit të peisazhit, ka ndikuar dukshëm në cilësinë dhe pastërtinë e ujit të liqenit. Megjithatë, duke u nisur dhe nga rritja e kërkesave mjedisore dhe detyrimeve që dalin nga përfshirja e pjesës shqiptare të liqenit në mbrojtjen e UNESCO-s, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ekzistojnë probleme, të cilat ndikojnë negativisht, si në mjedisin e pellgut ujëmbledhës dhe vetë liqenin, po ashtu dhe në zhvillimin e turizmit.

Më poshtë po listojmë disa problemet më kryesore, që kanë impakte negative në mjedisin në përgjithësi dhe në cilësinë e ujit të liqenit në veçanti:

1. Lumenjte që kalojnë në zona të banuara dhe ku derdhen ujrat e zeza të pa lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza. Konkretisht lumi i Verdovës, lumi i Remenjtit, lumi i Çërravës, lumi i Qytetit, lumi i Terhanit, lumi i Çervenakës, Piskopat etj.
2. Në gjithë shtretit e lumenjve, veçanërisht ata që kalojnë mes fshatrave Vërdovë, Rëmenj, Çërravë, Leshnicë, Piskopat etj, ka hedhje të mbetjeve urbane, plastike rroba të vjetra, plehura organike, mbetje ushqimore, mbetje të biomasës etj, të cilat ndikojnë direkt në cilësinë e ujit, të liqenit, nga veprimi i elementeve organikë që rezultojnë nga dekompozimi i tyre
3. Vend depozitimi i mbetjeve urbane në rajonin e fshatit Peshkepi.
4. Prerja e pyjeve që në fazën e parë të rritjes dhe shkalla e lartë e erozionit në tokat e abandonuara.
5. Ekzistenca e mbetjeve të mineraleve dhe qymyreve në ish stacionin hekurudhor të mallrave në Gurin e Kuq.
6. Sterilet e mineraleve dhe qymyreve pranë ish minierave dhe galerive të gjeologjise
7. Djegia e mbetjeve të biomasës të kulturave bujqesore dhe jo dekompozimi i tyre.
8. Kultura e dobët mjedisore në lidhje me mirëmbajtjen dhe menaxhimin mjedisor të pronës dhe ambienteve publike, krahasuar me mirëmbajtje dhe trajtimin e ambienteve private të banimit.



9. Mungesa e zbatimit të ligjit për problemet mjedisore. Mungon kombinimi i punes educative dhe ndergjegjesuese per mjedisin, me aplikimin e masave administrative.

10. Monitorim i dobët i evadimit të mbetjeve urbane, në fshatrat e Njësisve Administrative të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Pogradecit si nga ana e kryesive të fshatit, po ashtu dhe nga organet e qeverisjes vendore.

Për zgjidhjen e këtyre është e domozdoshme marrja e një sërë masash si në planin afat shkurtër dhe në atë perspektiv, si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm mjedisor, në mbrojtje të liqenit të Pogradecit, si një pasuri unike, për sot dhe brezat e ardhshëm, si pike kryesore në zgjidhjen e problemeve. Përfshirja e rinisë shkollore, gruas, OJF, biznesit, medias shoqërisë civile në kërkesat ndaj autoriteteve qendrore dhe lokale, për transparence në marrjen e vendimeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit në pellgut ujëmbledhës dhe cilësisë së ujit të liqenit Pogradec.

Vazhdimisht

2. Të kërkohet pranë organeve të qeverisjes vendore Bashkisë Pogradec dhe Njësisve Administrative, pastrimi i shtretërve të lumenjve nga inertet, mbetjet urbane dhe të biomasës me qëllim mbajtjen pastrimit të liqenit dhe evitimin e permbytjeve në periudhën vjeshtë dimër.

Korrik Tetor 2020

3. Bashkia Pogradec të kërkojë pranë qeverisjes qendrore, ndjekjen e procedurave për hartimin e projektit teknik për impiantin e pastrimit të ujrave të zeza në Njësinë Administrative Udënisht, si zone me potencial të lartë të zhvillimit të turizmit.

Vazhdimisht

4. Për parandalimin e ndotjes së liqenit nga mbetjet plastike si shumë të dëmshme dhe lehtësimin e grumbullimit të tyre në lumenjte e Vërdovës, Rëmenjit dhe Piskupatit të vendosjen rrjeta mbrojtëse për mbledhjen e mbetjeve plastike dhe mos lejimin e tyre në liqen.

Tetor 2020

5. Të kërkohet pranë Bashkisë Pogradec dhe SH.A Ujësjellës Kanalizime lidhjen e me rrjetin e kanalizime të ujrave të zeza, të tualeteve të disa familjeve në Qytetin Pogradec dhe në fshatrat Vërdovë, Buçimas, të cilat dhe sot shkarkohe në lumin e qytetit të Vërdovës dhe Rëmenjit.

Maj 2021



6. Të eliminohet vëndepozitimi i mbetjeve urbane në fshatin Peshkepi, duke marrë masa për rehabilitimin e tij, nëpërmjet ndërtimit të qendres së transferimit të mbetjeve në fshatin Gështenjas për në landfillin Maliq.

Tetor 2020

7. Për Njësitë Administrative Udënisht dhe Çërravë der në ndërtimin e impianteve të pastrimit të ujrave të zeza të kërkohet nga pushteti vendor, Bashkia Pogradec aplikimi i gropave septike për çdo familje fillimisht me punë educative dhe më vonë me sanksione bazuar në ligjet ekzistuese.

Qershor 2021

9. Të kërkohet pranë organeve qendrore dhe Ministrisë së Mjedisit, eliminimi i stoqeve të mineraleve pranë stacionit hekurudhor në Gurin e Kuq Pogradec si një pike e nxehtë mjedisore.

Mars 2021

10. Në bashkëpunim me shoqatat mjedisore të kërkohet nga biznesi reduktimi i perdorimit të prodhimeve plastike, si dhe grumbullimi selektiv i tyre me qëllim riciklimin e tyre duke sjellë të ardhura për komunitetin në punësim, kursimin e energjisë mbrojtjen e mjedisit dhe cilësisë së ujit.

Vazhdimisht.

Krahas masave të përshkruara më sipër, për këto problem në takimin perfundimtar me njësitë e pushtetit vendor, Këshillin e Bashkisë Pogradec, kryetarët e fshatrave dhe shoqatave mjedisore do rekomandomin disa prioritete afat gjata.

1. Hartimi i projekteve teknike për rihabilitimin natyror të shtretërve të lumenjve në hapësirën urbane të fshatrave i lidhur ngushtë me zhvillimin perspektiv urbanistik të tyre në funksion dhe të rritjes së turizmit.

2. Të rikonstruktohen shtretërit e lumenjve Vërdovë dhe Rëmenj për parandalimin e permbytjeve.

3. Të ngrihet një projekt pilot për ndarjen e mbetjeve urbane që në burim dhe gjetjen e trgrave të shitjes pranë kompanive të riciklimit. Për mbetjet e biomasës të aplikohet kompostimi i tyre për pleh organik dhe prodhimi i peletave për ngrohje.

4. Në zbatim të ligjit nr 9103, date 10.07.2003, "Për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare" të ngrihet pranë Bashkisë Pogradec në varësi direkte të Kryetarit të Bashkisë, Administrata e



Liqenit, e cila do monitorojë gjithë vijën bregliqenore, dhe cilësinë e ujrave të lumenjve, duke shërbyer dhe si një bërthamë shkencore monitoruese për gjithë projektet për mbrojtjen e liqenit.

5. Në kuadër të Ditës e Liqenit 21 Qershor, Bashkia Pogradec të promovojë ide dhe projekte për mbrojtjen e liqenit, të shoqatave dhe institucioneve mjedisore, dhe aplikimin dhe zbatimin për vitin në vazhdim të projektit më të mire.

SKICA PER RRJETAT

RRJETA PER MBROJTJEN E LUMENJVE NGA MBETJET

PAMJE 3D

rrjete metalike

PREVENTIV

RRJETA PER MBROJTJEN E LUMENJVE NGA MBETJET

Nr	Elementi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Rrjete metalike rezistente	m ²	20	450	9000
2	Profil metalik	kg	300	135	40500
3	Blok beton C 16/20	m ³	0.16	8398	1335
4	Të ndryshme 10 %	LEK	10%		5084
SHUMA					54584
TVSH					10917
CMIMI / 1 COPE					65500

SEKSIONI TERTHOR

rrjete metalike

profil metalik Ø 100x3

blok betoni per fiksim 0.3x0.3x0x0.3

blok betoni per fiksim 0.3x0.3x0x0.3

RRJETA METALIKE